



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr. 14/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaç dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë të parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të vendosjes së materialeve promovuese në afërsi të qendrave të numërimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 05.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa ZP.Anr.14/2026 e datës 04.06.2026, e parashtruar nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të vendosjes së materialeve promovuese në afërsi të qendrave të numërimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 04.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.14/2026 nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë me të cilin pretendon se aktivistët e subjektit politik "Za Slobodu Pravdu i Opstanak" gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve të subjekteve të tjera politike vërejtën se përkrahësit e subjektit politik "Srpska Lista" në territorin e komunës së Leposaviqit, në disa vende në Leposaviq, në kundërshtim me rregullat e fushatës politike, kanë ekspozuar 2 pankarta të mëdha që ndodhen më pak se 20 metra përballë qendrës së numërimit (fotografia 3) dhe më pak se 50 metra nga vendvotimi në Leposaviq (fotografia 1 dhe 2), gjë që është në kundërshtim me kodin e sjelljes së subjekteve politike, duke përdorur objektet për promovim dhe duke shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se kanë vendosur pankartën në një vend që nuk është i paraparë për këtë. Andaj te njëjtit theksojnë se bazuar në dispozitat ligjore dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024, neni 7, pika 2.9 "Materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset brenda qendrave të votimit ose në distancë më të vogël se 100 metra nga hyrja e tyre", e cila lidhet me fushatën zgjedhore që është në fuqi dhe me ciklin dhe rregullat zgjedhore, duke qenë se shkelja është kryer më 04.06.2026 në orën 09:00, kërkojmë nga PZAP që ta pranojë ankesën të bazuar dhe të marrë vendim me të cilin dënohet subjekti politik "Srpska Lista - Zlatan Elek" në përputhje me normat ligjore dhe rregullat që lidhen me

fushatën zgjedhore. Si dëshmi kane bashkëngjitur fotot e pankartave të ngjitura nga "Srpska Lista" në Leposaviq, të cilat ndodhen 20 metra përballë qendrës së numërimit dhe më pak se 50 metra nga vendvotimi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lista Serbe theksojnë se lidhur me objektet e përmendura, materialet e lartpërmendura promovuese të vendosura me leje dhe pëlqime përkatëse, janë në distancë 170-220 metra, sipas matjes përmes aplikacionit Google Maps, dhe nuk shihen vizualisht nga qendra e votimit. Prandaj, te njëjtit theksojnë se nuk kanë shkelur rregullat zgjedhore të cilat paditësi i përmend në ankesën e tij, dhe propozojnë që ta refuzojë ankesën e paraqitur nga Nenad Rašić. Si provë kane bashkëngjitur fotografitë (print screen) nga aplikacioni Google Maps të objekteve të përmendura.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

- Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i ankesës subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë pretendon se subjekti politik Srpska Lista ka vendosur materiale promovuese në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024, neni 7, pika 2.9, duke ekspozuar pankarta në afërsi të vendvotimit dhe qendrës së numërimit në Leposaviq.

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr.07/2024, neni 7, paragrafi 2 nën paragrafi 2.9 përcakton se: *"Materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset brenda qendrave të votimit ose në distancë më të vogël se 100 metra nga hyrja e tyre"*.

Paneli pas shqyrtimit të fotografive të bashkëngjitura dhe pretendimeve të paraqitura në ankesë, konstaton se provat e ofruara nuk dëshmojnë në mënyrë të mjaftueshme dhe të besueshme vendndodhjen e vendvotimit ose qendrës së votimit konkret, poashtu nuk ka prova që vërtetojnë vendndodhjen e saktë të pankartave në raport me hyrjen e vendvotimit ose qendrës së votimi të pretenduar nga ankuesi, me çka edhe nuk vërtetojnë se ato janë vendosur në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 2 nën paragrafi 2.9 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, siç pretendohet me ankesë.

Paneli vlerësoj se ankuesi nuk ka paraqitur prova të cilat do të mund të vërtetonin pretendimin për shkelje të rregullave zgjedhore. Andaj nga gjitha ato fotot e bashkëngjitura me ankesë në asnjë moment nuk mund të vërtetohet pretendimi i tillë dhe se provat e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e pretenduar, si dhe me që barra e provës i takon ankuesit Paneli vlerëson se ankesa është e pabazuar me fakte dhe me prova konkrete dhe se një pretendim i tillë është i përgjithësuar dhe i pa argumentuar.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse".

Andaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZP.Anr.14/2026 më datën 05.06.2026

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.